

## INTERVISTË ME ZYRAFETE BERISHA - LUSHAJ

Prishtinë | Data: 17 nëntor, 2021

Kohëzgjatja: 75 minuta

Të pranishëm:

1. Zyrafete Berisha - Lushaj (E intervistuar)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Anita Susuri:** Zonja Zyrafete, nëse mundeni me u prezantu, me na tregu për biografinë e juj diçka pak. Pastaj, për vendin e lindjes, datën.

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Faleminderit. Fillimisht du t'ju falenderoj shumë për ftesën që m'keni ba. Faleminderit që zgjedhët emrin tim n'mesin e shumë emrave të veçantë. Histori t'ndryshme, biografi t'ndryshme. Unë sot erdha me shumë qef te ju dhe do t'përpiqem që gjitha ato që unë i kom menu rrugës që unë i kom në menje, mos t'i hup sot me fjalë.

Unë jam Zyrafete Berisha-Lushaj. Mbiemri parë është Berishë. Jam lindë dhe rritë n'fshatin Pozharë, ni fshat i komunës të Deçanit. Nuk o fort larg. Në ni familje t'madhe, në ni familje që si traditë kishte shkollimin e lartë. Edhe une si vajzë fshati pata fatin që t'shkollohem, domethanë ishin vitet e '70-ta. Edhe krejt çka une kom ba njet' është falë prindve që zgjodhën që unë t'shkollohem n'mesin e pak femrave asokohe që kanë mri shkollimin e lartë.

Shkollën fillore n'fshat për t'vazhdu mandej shkollën e mesme të mjekësisë, dega farmaci në qytetin e bukur të Prizrenit. Aty katër vjet. Pas katër vjet në Prizren nuk kishte studime për farmaci asokohe në Kosovë, ishte vetëm shkolla e mesme në Prizren. Aty bashkohen t'gjithë shqiptarët dhe gjithë ata që e donin farmacinë. Po, vetëm aty u ndërpre shkolla e mesme e farmacisë.

**Anita Susuri:** Zonja Zyrafete, nëse mundeni me na folë për fëmijërinë, kujtimet e para.

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Faleminderit. Thashë edhe ma herët se unë isha vajza e vogël n'familje edhe noshta kjo më bani që unë të shkollohesha n'atë kohë. S'e di! Ni fshat i vogël.

**Anita Susuri:** Sa fmi keni qenë n'familje?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Kemi qenë katër djem, tri vajza. Unë fmia i vogël edhe ishin tre vllazën që studiojshin atë kohë edhe falë tyne që m'përkrahën edhe falë prindërve që bon t'pamundurën që une t'vazhdoj shkollimin. Pas shkollës fillore, tetë vjeçare prindët vendosën që unë t'vazhdoj në qytetin e

bukur të Prizrenit farmaci. I falenderoj shumë që zgjodhën qytetin ma t'bukur që unë t'kryj për farmaci.

**Anita Susuri:** Deshta pak me u nalë te prindërit e juj se po i përmendni, si i kujtoni ata? Babën? Nanën?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Dy prindërit e mi e ka ditë vlerën asokohe, vlerën e shkollimit, kanë bo t'pamundurën. Kanë qenë punëtorë, nana u marrë ma tepër me punë dore, përveç angazhimeve me fmi edhe angazhimeve familjare. Edhe baba, po ashtu, ka punu n'fshat, në bujqsi, në ndërtimtari që me i mbledhë t'hollat me u shkollu. Ishin tre djem edhe unë vajzë, ishin katër fmi që u dashtë me ia pagu...

**Anita Susuri:** E si fmi a ju kujtohet shpija juj edhe a keni jetu n'bashkësi aso kohe?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Kemi jetu n'bashkësi, familje e madhe. Qysh atëherë që maj mend unë edhe axha, axhallartë e mi kanë qenë të shkolluar dhe kjo ishte një përparësi për mu. Ka pasë prej familjes edhe doktor shkence, prej familjes. Kështu që, ishte një, një familje që e donte shkollimin e lartë, nuk u mjaftojke vetëm me shkollimin fillor, shkollimin e mesëm edhe shkollimin e lartë.

**Anita Susuri:** A janë shkollu ata dikund, domethonë, ni kohë kur ka qenë Jugosllavia a kanë qenë t'shkollum jashtë dikund, jashtë...

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po, ka pasë edhe jashtë. Po, ka pasë edhe jashtë. Sigurisht t'u i ndihmu secili tjetrit me t'ardhuna me ekonomi. Ka pasë në Bashkimin Sovjetik që ka doktoru axha, ka pasë...

**Anita Susuri:** A ju kujtohet juve naj tregim si ka shku ai deri atje?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Në... sigurisht se me shumë mund edhe me shumë sakrificë se u dashtë shumë të holla, por ia ka dalë. Edhe na jemi shumë krenar edhe për vllaznit, se une e thashë, mas katër djemve jom unë edhe secili ka kry studime n'atë kohë. Secili, tu ia nisë prej juridikut, ekonomi, kimi, biologji. Kështu që, unë nuk e kisha edhe fort zor, nuk e kisha, që unë t'vazhdoj rrugën e tyre.

**Anita Susuri:** E di që ju ma vonë jeni angazhu n'do, lidhur me çështjen Nacional Çlirimtare, por po më intereson a ka qenë edhe ma herët kjo n'familjen e juj?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po sigurisht se unë, sigurisht se unë jom frymëzu prej diku si e vogël që isha. Jom frymëzu prej familjes. Ishte koha atëherë ku nuk u pajtum me regjimin serb edhe unë tu i pa familjen teme, ish familje e madhe, tu e pa edhe tu lexu edhe vendosa që vitet '82, '81 mu m'nxuni në Prizren, '82 kur ishte përvjetori i demonstratave, Lëvizja Studentore, edhe aty fillova t'jem aktiviste dhe t'boj edhe unë gjanë ma t'vogël ndoshta. Përpjekjet ishin edhe dëshira ishte shumë e madhe që t'jem pjesë e Lëvizjes Studentore. Atëherë...

**Anita Susuri:** Po para se me vazhdu aty po du edhe pak me u kthi te vendimi jot...

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Patjetër.

**Anita Susuri:** Nëse mundeni pak ma shumë me na tregu lidhur me qat' familjen e ju' edhe kush ka qenë ma konkretisht i angazhum, në çfarë çështje edhe a ka pasë problem edhe me pushtetin atëherë, se ka pasë edhe njerëz t'përndjekur që kanë qenë n'atë kohë. Domethonë me na fol në lidhje me këtë.

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Sigurisht që kanë pasë probleme me pushtetin, jo vetëm familja jeme, po secila familje që ka shkelë dhe i ka cënu pushtetin e asokohe kanë pasë problem. Kanë qenë t'largum prej pune, kanë qenë t'përndjekur politik edhe e kanë bo ni jetë të vështirë, ni jetë ilegale.

**Anita Susuri:** A kanë pasë...

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Kanë pasë të burgosun, të gjakosur, të malltretuar, jo vetëm familja jeme po si t'gjithë tjetër asokohe. Ka pasë edhe n'familje teme tortura, ka pasë shumë.

**Anita Susuri:** Kush ka qenë, për shembull, ose a ju kujtohet juve ndonjë tregim që ka pasë?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Nuk m'kujtohen tregimet se unë pak ma e vogël n'familje. Nuk m'kujtohen shumë tregime, po e di që, që, e kanë shky flamurin serb, Kosova Republikë kanë folë, kanë qit parolla t'ndryshme asokohe. Me ni fjalë kanë dashtë republikë, kanë bo revolucion, janë përpjekë me bo revolucion. Dhe kjo, kjo sigurisht që u pa n'sytë e qeverisë asokohe, e cila të dënonte në mënyrë familjare, në mënyrë zinxhirore të dënonte. Nëse ni anëtar i familjes binte në sy [të pushtetit], e psonin t'gjithë familja se kjo shkojke n'mënyrë zinxhirore.

**Anita Susuri:** Na keni tregu për nanën e ju' edhe që ka punu edhe ka pasë dëshirë me punu punëdore, po a ka qenë kjo si lloj pune me fitim apo vetëm për qefi ka punu?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Punë me fitim, punë me fitim se si t'gjitha nanat asokohe u dashtë që veshmbathja të sigurohet me punëdore. Ndoshta deri vitet e '70-ta ka qenë. Kështu që, unë në shenjë falenderimi për nanën dhe për t'gjitha nanat asokohe, unë kom vendosë edhe e kom bo ni libër që do ta keni n'dorë edhe ju. Për t'respektu të gjitha nanat shqiptare asokohe dhe jam përpjekë që traditat dhe zakonet asokohe t'mos harrohen,[por] të jetësohen. T'u pasë parasysh që rinia tash ma tepër mas rrjeteve sociale. Le t'jesin dokument ato zakonet e asaj kohe, tradita edhe rrëfime ka, rrëfime interesante. Kta e kom bo për dashninë për nanat edhe për gruan e asaj kohe.

**Anita Susuri:** Ju, m'tregutë që keni, vendi ku keni jetu, ku jeni lindë, keni shku në Prizren keni vazhdu shkollën e mesme. Kah ka ardhë ma s'pari kjo dëshira për me vazhdu në farmaci? A iu ka kshillu dikush, a keni pasë dëshirë apo?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Faleminderit për pytjen. Unë isha e re masi e krewa shkollën fillore. Ishte babai, vllaznit që vendosen që unë t'shkoj në Prizren. Nëse don t'shkollohesh është qyteti i bukur i Prizrenit edhe farmacia si profesion m'pëlqeu. Atje marova katër vjet, domethonë jetova katër vjet në

Prizren. Mirëpo, pasi përfundova shkollën e mesme vendosa t'studij, nuk u mjaftova me ni shkollë t'mesme. Meqenëse, nuk kishte farmaci zgjedha Letërsi e gjuhë në kryeqytet, në Prishtinë.

**Anita Susuri:** E kur keni ardhë në Prizren, a ka qenë hera parë që keni dalë jashtë vendit t'juj apo?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Ishte hera parë, si vajzë fshati ishte hera parë (buzëqeshë). Ishin ato kujtimet ku ishte qytet i madh për mua asokohe...

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë Prizreni n'atë kohë?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Prizreni n'atë kohë ka qenë ni qytet i bukur, mirëpo gjuha pak a shumë nuk e kom kuptu se në Prizren ka shumë që jetojnë...

**Anita Susuri:** Që flasin gjuhë t'huja.

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Që flasin edhe gjuhë t'huja, ka prej fshatrave, ni gjuhë pak e vështirë. Mirëpo, unë e msova edhe m'hini n'qef. Tani katër vjet isha si e re aty, kishim shoqni, ishte ni pjesë e bukur e jetës që s'e harroj kurrë.

**Anita Susuri:** A keni jetu me qira apo si?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** N'konvikt. Ishte konvikti tek [Kompania] Farmakosi, atëherë ishte Farmakosi, ni konvikt i vogël aty. Aty u shoqnum pastaj me shumë shoqe e jetuam bukur. Ishte edhe vllau student asokohe në Prizren. Ai studionte për fizikë, kështu që e kisha ma lehtë me udhëtu me vlla, me u kthy pastaj, çdo dy javë me ardhë n'familje te prindët. Po, ishte pjesë e bukur kjo, ishte jetë e mirë.

**Anita Susuri:** A ka ndodhë, domethonë, si vajzë e re me shoqe me dalë, çarshia ka qenë apo dikund me u shëtitë?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Nuk jemi dalë. S'e di! Ishte ai paragjykimi që për me kanë nxanëse e mirë, vajzë e mirë duhet edhe kur t'del në qytet me dalë me uniformë, uniformë t'shkolles. Ishin ato bindjet tona që na duheshim.

**Anita Susuri:** E diçka tjetër që mundeni për shembull me veçu ose naj përjetim të qasaj kohe? Për shembull, si kanë qenë profesorat? A iu kanë këshillu? A kanë pasë...

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Profesorat kanë qenë shumë t'mirë. Ne kemi msu shumë se ishte ajo bindja që nëse e hupë vitin duhet me lonë shkollën edhe ne kemi msu fort, fort prej frikës që nëse hupë ni vit nuk mundesh me vazhdu pastaj. Ashtu jemi kanë në, të këshillum prej prindërve. Kështu që, përfundoi edhe shkolla mesme, përjetim i mirë, kujtime t'mira, si e re, si t'gjithë maturantët. Si t'gjithë, ajo gjeneratë ka lanë kujtime t'mira.

**Anita Susuri:** Sigurisht keni pasë autobusin si mjet transporti për me shku n'fshat. A keni shku shpesh n'shpi? Apo si?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** N'shpi çdo dy javë jemi shku, kom hecë n'kamë prej fshatit Pozharë deri në Deçan, në Deçan autobusi. Deçan, Gjakovë, Prizren.

**Anita Susuri:** Sa ka qenë gjatë me ecë?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Ka qenë ndoshta ni orë me ecë n'kamë.

**Anita Susuri:** A keni pasë gjithmonë shoqni?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po, kom pasë vllaun e kom pasë. Dy vjet e para e kom pasë vllaun e madh që studiojke për fizikë. Kur ai maroi studimet dy vjet erdh vllau tjetër që u punësu në Prizren në ni shkollë, ni fshat rrethit të Prizrenit [si] biolog. Kështu që, m'ra qe katër vjet me udhëtu me vllazën, nuk kom udhëtu vetëm. Edhe ishte mirë kjo për mu, isha ma e sigurtë, u nijsha ma mirë.

**Anita Susuri:** Po dashta me pytë edhe, po kuptoj që familja juj ka qenë edhe e shkollume edhe ma e ngritun sa i përket këtij aspekti. Por, a ka pasë prej fshatarëve, prej fqinjëve ndonjë irritim për vajzat që janë shkollu n'atë kohë?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** S'e di, atëherë ishin vitet e '70-ta, ndoshta edhe jo aq shumë t'u i krahasu me vitet e '50-ta, me vitet, këto që janë shkollu para meje ndoshta pak janë numëru edhe n'gishta. Por, për vite '70-ta ndoshta jo edhe shumë paragjykime, ishin pak paragjykime po ma tepër ishin ekonomia. Mundësitë e vogla ekonomike që nuk kanë mujtë vajzat me shku edhe kanë mbetë me ni andërr tanë jetën që s'kanë mujtë me u shkollu. Se viteve të '70-ta pak a shumë veç fillunë vajzat me konë ma t'lira.

**Anita Susuri:** E prej Prizrenit kur e keni përfundu shkollën, jeni kthi prapë n'fshat?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po.

**Anita Susuri:** Pastaj, m'tregutë që nuk ka pasë, domethonë, n'rrethin tond për me vazhdu...

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Studime për farmaci nuk pat'.

**Anita Susuri:** Si erdh pastaj deri te Gjuha shqipe?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Erdh te Gjuha shqipe sepse qysh herët, une, edhe gjatë shkollimit t'mesëm merresha pak me shkrime, me poezi. Edhe me vazhdu Mjekësi të përgjithshme nuk e kisha n'qef se nuk kom fort zemër për xhilpana, për injeksione, për gjak. Nuk e kom dashtë kto. Kom ikë prej mjekësisë pastaj, se farmacia edhe mjekësia nuk janë njejtë. Farmacia shëron me barna, mjekësia me xhilpona. Kështu që, unë i kom ikë kësajna. Edhe prindët për me ma plotësu dëshirën mu që une mos me mbetë vetëm me ni shkollë t'mesme, i falenderoj edhe tash që s'janë, që ma plotësun ni andërr shumë

t'madhe që unë të studioj. Edhe mora Letërsi e gjuhë, e mora me qef edhe pse ishte vështirë me kalu prej Mjekësie në Letërsi, po vullneti edhe dëshira unë ia dola. Mirëpo, gjatë studimeve, aty tani kom pasë, ka fillu ni dramë interesante për mu. Isha dishka...

**Anita Susuri:** Para se me vazhdu anej po du, domethonë prej fshatit t'juj ju keni shku në Prizren që është qytet ma i madh edhe ma i zhvillum me thonë. Po tash Prishtina n'vite të '70-ta u konë tu u zhvillu. Si e keni pa ju për shembull? Ku keni banu? Keni banu n'konvikt me siguri. Si ka qenë krejt ajo pjesa? Qyteti? Qendra?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Unë n'vitet e '82-ta kom ardhë në Prishtinë, kështu që i bijnë vitet e '82-ta në Prishtinë. Sigurisht që Prishtina ka qenë ndryshe, po ka qenë me plot jetë, plot gjallni. Nuk ishin kto lokalet që hijmë me pi kafe tash. Krejt çka u takojshim mes veti tash edhe krejt çka mujshim me u pa ishte nifarë shëtitore i thojshim ne. Shëtitore që u sillshim. Shëtitore. Aty kanë dalë studentë, punëtorë, njerëz që me u fresku n'mramje, ma tepër sesa nëpër lokale.

**Anita Susuri:** A keni shëtitë edhe ju?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Kemi dalë. Kur shkova në Prishtinë n'studime qilloi të jetë vllau i vogël student i Fakultetit Ekonomik edhe prapë me vllaun. Po. E kemi shiju mirë, e kemi shiju mirë atë pjesën e studimeve, sidomos vitet e para isha brucoshe isha edhe kemi shiju shumë mirë. Sa mbaj mend unë, sa di unë si e re, jemi mjaftu me pak, jemi mjaftu ndoshta me diçka që ke ble. Ndoshta n'vit ni sen t'bukur e ke ble edhe jemi kanë shumë t'lumtur me ata që ne kemi pasë. Kemi jetu thjeshtë, po mirë.

**Anita Susuri:** Tash po m'intereson rrëfimi i juj krejt qysh ka ndodhë me antarësimin në ilegale? Qysh ka shku kjo punë? Qysh keni marrë ju vesh edhe tregutë që prej familjes, domethonë ka qenë kjo qajo lëvizja me bo diçka ndryshe kundër sistemit me shku. Po qysh ka ardhë deri te qajo ideja?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Sigurisht që kjo nuk erdhi rastësisht sepse gjatë gjithë kohës unë jom ushqy me ndjenja patriotike, t'u fillu prej leximeve, prej veprave, prej shoqnisë, prej kolegëve edhe kjo nuk erdhi rastësisht. Kështu që, ishte atëherë thirrja, viteve '82 ishte thirrja, "Atdheu n'rrezik" dhe ne si studentë donim t'bënim diçka. Bëm revolucion atëherë kur rezistenca ishte pothuajse e ngrirë. Fillum me lidhje t'mshefta ilegale...

**Anita Susuri:** Keni ndëgju përmes shokëve shoqeve apo si? A osht' folë?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Fillimisht kjo është folë në fshat. Në fshat mbahen tubime, tubime. Dikush shante qeverinë serbe që po i malltreton edhe po i vret studentët, dikush shante studentët pse po e prishin rendin edhe qetësinë e asaj kohe. Dikush pa e ditë, dikush nga frika, dikush nga mosdija, dikush nga frika. Edhe ishte ni kaos, ishte ni mjegull derisa u qartësun. Se fillimisht njerëzit, ndodhi shumë shpejt kjo kryengritja edhe Lëvizja Studentore që hyni në histori që më pas e solli edhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

**Anita Susuri:** Domethonë, ju prej fshatit ka fillu qikjo edhe ktu veç keni fillu me ndëgju që po ekzistojka ni lëvizje...

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po, prej fshatit, po. Në çdo fshat janë mbajtë tubime, janë mbajtë konsultime me burrat e fshatit, “Pse po ndodhë kjo, kah po vjen kjo se...” Kështu që, kjo veç murrë përmasa të mëdha, njerëzit u vetëdijësun secili. Edhe unë isha, edhe unë e gjujta ni gur t’vogël.

**Anita Susuri:** Si ndodhi që keni hy në ilegale?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po ishin përvjetori i demonstratave t’vitet ‘81, unë asokohe jetoja n’konvikt, në Qendër të Studentëve, n’konvikt edhe sigurisht nuk m’kalojke asnjë pa e marrë vesh, pa e ditë. Edhe isha përgatitun që do t’ndodhë diçka, isha përgatitun se ishte edhe vllau në Lëvizje edhe isha e përgatitun që nëse ndodhë diçka, une e di çka t’flas, e di ku jom edhe e kom ditë shumë mirë qëllimin. Nuk po e boj veten hero nashta ose heroinë se ishim shumë t’vogla atëherë, ishim studente. Po me aq sa na ka rreh zemra atëherë na kem pasë vullnet edhe kem pasë vizion për vendin. Kemi qenë shumë t’forta edhe shumë t’informume mirë. E kem ditë qëllimin e kem ditë edhe fundin se...

**Anita Susuri:** E në protesta domethonë, ju thatë që keni qenë pjesë e Lëvizjes Fortuna që...

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po, po. Ishte ni grup i vogël, i msheft aso kohe që unë e rujta temën edhe falë... edhe vajza jem e ka emrin Fortuna që e kam mbajtë msheft këtë emër gjithë jetën se e kisha n’qef këtë emër me jetësu. Kështu që, na merreshim vesh me mbledhje t’mshefta nëpër Prishtinë pastaj në Deçan, n’fshat. Ishte ai grupi jonë që na... aty merrnim vendime, aty diskutonim se çka do t’bohët hapi i radhës. Kështu që, frika ish shumë e madhe edhe lëvizjet ishin shumë t’mëdha t’qeverisë serbe aso kohe, nën hetime ishim t’gjithë. Po vullneti dëshira edhe strategjia që kemi luftë na ka qenë e rëndësishme.

**Anita Susuri:** Cilat kanë qenë aktivitetet e juja? Çka keni bo? E di që shkrimi i disa parollave “Kosova Republikë”, nëse mundeni ma shumë për qita me na folë?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Ti sigurisht që je informume meqenëse e ke edhe librin të botuar nga Teuta Hadri. Aty janë disa intervista, jemi secila aty jemi se ilegale janë shumë. Edhe Teuta u përpjekë me i futë n’libër edhe ju aty keni gjetë emrin tem. Ju falënderoj shumë që m’keni dhanë mundësinë që t’jam edhe unë n’mesin e njerëzve t’veçantë. Sepse aso kohe nuk ka qenë e lehtë për ni vajzë s’ka qenë e lehtë, ni vajzë me u burgosë ka qenë, sigurisht për nana tona ka qenë ni grusht shumë i ranë se nuk e ka ditë se si do t’dalim e si do t’shkojë puna.

**Anita Susuri:** Nëse mundeni me na folë për Lëvizjen ilegale si keni hy? Si keni kuptu për këtë lëvizje?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po meqenëse ju e keni gjetë emrin te ky libri aktiviteti i grave ilegale për shlirimin e atdheut atëherë po zgjenohem pak n’këtë pikë. Emrin ilegale e kemi vu pas shlirimit, domethonë atëherë ishte Lëvizja Studentore ndërsa ilegale e kemi vu këtë emër pas shlirimit sepse ishim ilegale. Që do të thotë, ishim të fshehta. Çdo gja u bo e msheft se ashtu ka qenë formati edhe



ashtu ka qenë... janë mbajt mbledhje të mshefta, e kemi ditë secila për rrezikun që do t'na ndodhë. Ishim t'reja ndoshta s'kemi ndi edhe fort rrezik asokohe se ishim t'reja.

Kështu që, nëpër demonstrata ma shumë, aty kemi dalë n'demonstrata t'gjithë studentët, sidomos para konvikteve. Kemi qenë shumë mirë t'organizuar, e kemi mbrojtë secili njani-tjetrin, kjo ka rëndësi me folë. E kemi mbrojtë njani-tjetrin shumë. "Kosova Republikë!", "Duam liri!" Këto parollat që janë të njohura për secilin. Janë edhe n'histori këto parolla që i kemi folë. Unë dola me shoqe para oborrit t'konvikteve studentore. Takohna edhe me vllaun, takohna me shumë shoqe, me shumë kolegë. Nuk e kom ditë që ne po fotografohemi, secilën pozitivë sepse ishin masat shumë të rrepta policore. Ishin jashtëzakonisht të rrepta. Kështu që, ranë n'gjurmë edhe pas ni kohe na burgosen mu, vllaun edhe ni shoqe. Tri vetë përneherë na kanë arrestu. Edhe pastaj aty kanë fillu torturat, nën hetime ni kohë derisa janë caktu ditët e burgut.

Ka qenë ni periudhë shumë shumë e tmerrshme, për shkakun që u dashtë me ditë çka po flet. Problemi im ish me i mbrojtë tjetër, nuk ish atëherë problemi jem. Unë, unë ku jom. Unë e disha që jom n'dorë tyne po ish problemi qysh me i rujtë të tjetër. Kjo kish randësi shumë. Aty e kisha hallin une. Edhe në ni përlëshje të ashpër, në ni përlëshje të përgjakur u arrestum. Edhe mbaj mend ni pjesë sepse vllau ishte tri vjet ma i madh se unë, kishte përvojë ma shumë. Sigurisht une prej tij kam marrë veç ma shumë edhe gjatë hetimeve unë takohna me vlla ai durtë lidhë une durtë lidhë edhe njanën dorë e kish me ni shok edhe veç mbaj mend që ai thotë, me dorë bon që mos fol {shpjegon me duar}.

Ky ka qenë momenti që unë nuk e harroj kurrë se isha e re, noshta edhe kisha folë, noshta edhe kisha tregu se dajaki çka s'bon. Mirëpo, m'kujtohet që vllavi tri vjet para meje ishte ma i guximshëm, ishte ma edhe thotë, "Mos fol!" Veç këtë pjesë e mbaj mend. Edhe kjo ka qenë ni, kjo ka qenë ni dhuratë ma e madhe për mu n'jetë që mu mbani kjo si jom edhe mboni shumë t'fortë ai moment që unë t'mos tregoj emra, që unë t'jom e fortë. Se noshta edhe kisha folë se e re edhe nuk... kështu që, kjo si rezultat dul që...

**Anita Susuri:** Kto ju ka thanë kur jeni arrestu?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Nuk u burgos kush prej prej bashkëpunëtorëve t'mi, nuk u burgos kush sepse ju bo *block* atyne emrave sepse edhe pse u torturum shumë qëllimi ishte t'mos mos me përmend emra. Edhe kjo ka qenë gjaja ma e mirë n'botë, n'jetë që m'ka ndodhë kjo.

**Anita Susuri:** Kto ju ka thanë tu u arrestu apo? Vllau?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Na kanë arrestu, ishim nën hetime me na marrë n'pytje. Na kanë da femrat ni vend, djemtë ni vend, nuk ishim mo bashkë. Nuk ishim mo bashkë, nuk ishim mo bashkë. Vllaun e çun me djem, mu me femna. Ishte grupi, isha me shumë shoqe aty... në Gilan ma shumë kom pasë, kom pasë në Suharekë. Aty secila ishte e përgjakun. Secila ishte qysh i kanë marrë n'rrugë, qysh i kanë marrë n'shpi. Nuk e di, ishte ni përvojë e re, ishte diçka interesant. Edhe gjatë kohës kur ne nën hetime aty e kaloj vllaun prej larg edhe veç, mrena mundësive shumë t'vogla arriti m'thotë që, "Mos fol!" Kjo është gjaja ma e mirë n'botë që m'ka ndodhë.

**Anita Susuri:** Ju jeni arrestu...

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Me 11 mars.

**Anita Susuri:** '82, domethonë ka qenë...

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** '83, 11 mars '83. 11 mars ishte përvjetori i demonstratave të vitit 1981.

**Anita Susuri:** Paraprakisht çka ka ndodhë? Ka qenë ni organizim që ju e keni...

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Ishte përvjetori i demonstratave. Ishte një demonstratë masive, ni demonstratë shumë e madhe ishte, kishte plot aty edhe pjesa tjetër n'hetime ishte tmerr. Nën hetime është tmerr se provokime shumë t'mëdha. Ka pasë provokime shumë t'mëdha. Ka pasë raste kur kanë inçizur njerëz tu bërtitë, njerëz tu i malltretu. I kanë inçizur edhe m'kanë thanë, "Ky osht' baba", edhe, "e ki, ni mur t'ndan me babën edhe ky është zani babës". Edhe n'ato momente ti s'ke mujtë me ditë, a osht' zani babës apo i kujt osht'. [Këtë e kanë bë] Në mënyrë që na prej frikës me tregu emra. Qëllimi i tyre ish [na] me tregu emra. Nuk isha interesant unë si Zyrafete, si person. Unë si person u mora, por unë t'kom edhe shumë tjerë mas, t'qes shumë emra. Edhe kta emna kom mujtë m'i qit veç nga frika, nga frika tu m'pru inçizime, tu m'thonë, "Ta kena mytë krejt familjen. Vllaun që e ke pasë me veti ta kem vra, ta kem mytë. Edhe vllau po tregon gjithçka për ty, ti s'po tregon për to". Domethonë, kto kanë qenë pytjet ma provokuese.

**Anita Susuri:** Domethonë, ka pasë edhe torturë psikike edhe fizike?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Ka pasë, te dyjat kanë qenë. Po unë e kom ni zanin tu... deri vonë nuk e kom ditë që s'osht' baba. Deri vonë unë kom menu që babën e kom aty edhe familjen e kom aty. Edhe ka pasë tortura t'ndryshme, "Ti kur del edhe nëse del prej ktuhit najhere e gjallë, ty s'ka me t'folë kërkush. Ti ki me qenë vajzë e mjerë". I kisha ni muj ndoshta që isha feju unë edhe kisha edhe tortura tjera. Kisha që, "I fejumi s'ka me t'marrë kurrë edhe ti e ke ndytë familjen", e ksi gjana që ishin shumë tmerrshme.

Unë kom mendu që s'e kom asni t'familjes gjallë, nuk e kom ditë. Ka pasë raste tjera kur m'kanë thanë, "Nëse ti tregon, unë muj me ta pshtu familjen", ka pasë edhe asi raste. Ishim grup, po e mira e krej ksaj ka qenë që na që u murëm n'pytje me atë grup shoqe, që unë i du shumë dhe i përshtëndes shumë sot, janë mikeshat e mia ma t'ngushta edhe e di që ato kanë kapacitetin e duhun për t'bo gjana t'mira. Uroj që t'jenë mirë ato me familje pas kaq shumë vitesh. Që ne kemi përkrahë shumë njana-tjetrën. Ne edhe kur na kanë torturu na kanë pru... edhe nuk kem tregu çka na kanë bo pas murit neve polictë edhe njësia speciale, nuk kem tregu.

Edhe kem pytë, "Pse ki kto sheja? Pse floktë i ki kështu?" "Jo, vet", na nuk e kem frigu njana-tjetrën. Kjo ka qenë gjana ma e mirë që e kem bo. Na e kem rujtë njana-tjetrën shumë, kjo osht' pjesa e bukur që unë e mbaj mend se nuk kem mendu ma për veti na po kem mendu edhe shoqet aty. Mu m'kanë nimu

shumë shoqet që jom konë me to, m'kanë nimu shumë. Kom qenë pak ma e vogël se ato n'moshë, por kom msu shumë prej tyne. Uroj që ato t'jenë mirë me jetën edhe me familje sot sepse ato... kom msu shumë prej tyne edhe m'kanë dhanë forcë. I di me emra, ndoshta është ni libër për to, i falënderoj shumë.

## Pjesa e Dytë

**Anita Susuri:** Burgu i Mitrovicës ku keni qenë ju ka qenë famkeq, domethonë ka pasë ni drejtor që ka qenë Shemsedin [Sherafedin], ka qenë famkeq edhe ai. Po m'intereson, kushtet me siguri kanë qenë t'randa. Çka keni pa ju? Si e keni përjetu qat' qelinë? Qato dhoma? Qato zyra t'tyne?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po, unë do t'flas për këtë pikë. Meqenëse ju e keni marrë emrin pikërisht nga ky libër edhe kjo është arsyeja pse une, pse ju m'keni zgjedhë mu me ardhë ktu. Unë do t'jem shumë e kjartë edhe do t'përpiqem që t'jem plot histori. Sepse njeriu jeton për t'rrëfy, domethonë jeton për t'lanë gjurmë. Është ni shprehje që e flas shpesh, "Jeto për t'lanë gjurmë". Edhe unë sot jom shumë e lumtur që ju m'keni ftu ktu që unë t'lo gjurmë, që unë t'lo histori. Domethonë, pas shumë vjetve këto gjana janë t'randësishme për juve. Burgu i Qarkut ish Mitrovica e Titos, unë gjithmonë e thom ish Mitrovica e Titos për shkakun që qysh atëherë me ni qëllim ju vu emri Mitrovica e Titos, do t'thotë kjo është me qëllim me ditë.

Pse sot Mitrovica është shumë keq? Pse sot Mitrovica është e ndame? Jo rastësisht është nda Mitrovica, se atëherë është thirrë Mitrovica e Titos. Nuk u thirrë Peja e Titos ose Deçani ose Prizreni, pikërisht Mitrovica. Kjo ka t'boj me diçka. Edhe ai burg famkeq ishte n'formën e rrumullaktë, ashtu na thanë. Edhe kur unë hy kom mendu që ka veç vajza t'reja, veç aty kom pa edhe n'moshë kom pa. Mirëpo, me ndihmën e shoqeve që m'pritën aty kur i gjeta, me ndihmën e tyre na kemi kalu momentet ma t'vështira, i kem tejkalu. Jo kalu, po edhe i kem tejkalu. Gjithmonë t'u i ndihmu njana-tjetrës, gjithmonë t'u këshillu njana-tjetrën, gjithmonë tu i dhanë forcë, kurajo njana-tjetrës, se përndryshe nuk ke mujtë me qenë shumë e fortë se vetëm nuk munesh me ia dalë mrena katër mureve.

Ka pasë raste kur edhe vetëm t'kanë lanë, po unë aty kom mësu shumë, aty kom mësu ni shkollë. Për ato ditë unë e kom mësu ni shkollë edhe kom pa vajza shumë t'fuqishme që mu m'kanë lanë përshtypje. Ka raste interesante shumë që kanë dalë prej atyne ditve që nuk i harroj asniherë. Ka momente interesante, ka... unë kom vendosë që n'vitin 2021 ta botoj ni libër pas shumë vjetve mora guximin t'botoj libër. Sepse me botu ni libër osht' pak vështirë, sepse ke frikë se si do t'dalë, si do ta marrin lexuesit edhe kolegët edhe familja edhe m'ndihmun që ta kaloj këtë frikë.

Edhe aty n'libër shkrun ni pjesë, ni ditë e burgut, ni ditë shumë e veçantë e burgut edhe është me rëndësi me ditë. Sepse unë do ta bëjë këtë ndoshta si dramë për shkakun që ngjarjet n'atë libër janë t'sinqerta, domethonë janë... është ni pjesë shumë interesant e kam qit' në Facebook, është ni pjesë shumë interesant kur ni ditë, titulli është, "Vajzat, këpucë me taka", është ni pjesë aty n'libër që unë vet e kom titullu kështu dhe nuk e harroj kurrë. Disa e kanë harru. Kom folë me shoqet tani në Facebook,

jemi njoftu mas shumë vjetve falë rrjeteve sociale e kemi bo edhe ne rrjetin tonë dhe e kom ditë ku janë ato edhe kom shpalosë shumë kujtime.

Sot është ky rrjet, ju kur e lypni e gjeni. Na çka jetojmë o fjala, çka kemi arritë me bo n'familje edhe ku jetojmë. Shumica jetojnë jashtë. E kur i kom pytë kanë thanë, “Faleminderit shumë që ma kujtove atë ditë”. Domethonë, pse e murr emrin “Vajzat, këpucë me taka”, jo pse n'burg ka taka, jo pse n'burg jemi hi me taka na. Na kanë marrë qashtu qysh kemi qenë n'shpi, n'rrugë, n'fakultet, n'bibliotekë, n'familje na kanë marrë. Mirëpo, ni ditë ni shoqe prej Gilanit, pak ma e madhe se une n'moshë shumë e zoja shumë e mirë, [nga] Përlepnice e Gilanit. Ajo osht' n'libër aty me emën. Thotë, “Sot”, thotë, “do ta bajmë ni hecje ndryshe”. Kur them te hecja duhet t'ja u shpjegoj juve si vajza t'reja që niherë n'ditë kem pasë n'shëtitore me dalë me marrë ajër, ka qenë si rregull e burgut.

Edhe aty me durë, sigurisht t'lidhme, kem pasë me u sillë si shëtitore e improvizuar. Aty kanë qenë rojet, ato rojet naltë {shpjegon me duar} na përcillnin edhe na ishim t'radhitura njëra pas tjetrës. Thotë, “Sot do t'kemi me mathë këpucë me take”, “Pse?” I thojmë na, “Pse? Ku do t'dalësh ti?” Thotë, “E di unë pse”. Disa i kishim këpucët me take, disa. Bile m'kujtohet ajo i ka pasë shumë këpucët e bukura ajo. Unë i thojsha, “Ku i ke ble se?” Të kuqe janë kanë me një fjong. Tha, “I kom ble”, tha, “me kursime t'mia”, po thashë, “Sa t'mira moj kto këpuca”, s'e di m'pelqejshin. Veç sa i kish ble. Ishin t'reja, m'tregon qysh i ka ble me kursime t'veta se nga ajo anë duhon, kultivojnë duhonin shumë ajo pjesa e Gilanit anena edhe me ato t'holla. “Mirë”, tham na edhe vendosim secila këpucët m'i mathë me take.

Para se me dalë na bijnë ushqimin, mëngjesin, pak bukë, pak djathë, pak kripë, pak sheqer, pak çaj. Domethonë, ushqimi i mëngjesit i dobtë po ishim t'reja edhe nuk nuk na lijke shumë përshtypje ushqimi edhe ashtu s'kishim apetit se ishim t'reja. Edhe dulëm na n'shëtitore, mirëpo pse ishte qëllimi i këpucëve me taka e mësum kur na tha, “Hecni secila me ni ritëm”, thotë, “Po si është ky ritmi?” Thotë, “Do t'ecim me ritmin ushtarak”, që i bjen hapat ushtarak, thotë, “Se këpucët e taka kërsasin shumë, edhe na secila me ritmin”. “Okej”, thojmë, edhe na dalim.

Ja nisim n'shëtitore, ishte ritëm ushtarak edhe ishte ni *bum* {onomatope}, ishte ni gja e papritun për rojet naltë. Mirëpo, na e morëm atë vrullin me ecë edhe s'pat' kush n'botë që na nalë, jo që ishim aq trimnesha, po se e morëm ni forcë me atë fuqinë rinore domethonë. Na nuk kishim frikë atë ditë edhe ecëm me ritmin ushtarak secila {shpjegon me duar}. Ato krisma m'dukën që murën krejt burgun atë ditë. Ato krisma jehunë shumë naltë. Rojet nuk ndërhyjnë derisa na t'përfundojmë. Nuk e di. Edhe ajo shëtitore e improvizime rreth, naltë n'katin e dytë e murëm vesh që ka të burgosur burra, djem. Na ishim ni kat ma poshtë vajza, naltë e murëm vesh që ka burra se mrena katër mureve ti nuk ke pasë asnjë informacion. Po e murëm vesh që ka burra.

Edhe për çudi se nihet ni za naltë, thotë, “Ju jeni ushtria e Kosovës. Ju jeni ushtria e popullit shqiptar”. Se ngjante në ushtri ajo dhe për ne kjo ishte shumë. Domethonë, llogarit vitet e '83 m'u folë për ushtri, ishte shumë herët kjo. Më pas për çudi dikush e lëshon ni letër. Ishte maj, ndoshta fundi i prillit, maj që kish fillu dielli, rrezet e diellit me dalë si pranverë e hershme. Edhe e lshon ni letër prej naltë, sigurisht se ajo letër ka qenë letër e kutisë t'duhanit se nuk lejohej letra aty, ndoshta laps po po letër jo. Edhe e

ka hekë prej duhanit edhe e ka shkru, çka ka shkru n'letër nuk e dishim, vetëm që e dishim se ra ajo letër edhe vezullojke shumë.

Po, çka t'bojmë na? Ish sfida e dytë na ku po dalim tash edhe secila ia bojmë me shenjë njanës kur sillëshim ia bojmë me shenjë që shkele letrën në mënyrë që t'mos vizllon me e pa rojë. Ta mbrojmë na ata që e gjujti, duhet me mbrojtë. Se na ishim të vetëdijshe që ai që e gjujti letrën, që e hodhi letrën do ta gjejnë ata edhe kush e di se si do t'përfundojë ai. Po tash çka do t'bojmë na, si do t'gjindemi që ta mbrojmë ata edhe vetën. Secila që u sillke e shkelke që mos t'vizllojë ajo, t'mos ketë shkëlqim, mos t'ju bjen n'sy. Njo që ishte ma e vogël me shtat prej neve sigurisht që e pat' fatin me u ulë me e mar. Njo që ish ma e vogël me shtat që mos me u vrejtë shumë prej rojeve.

Mirëpo, ajo që e merrke letrën ishte e rrezikume, po si të kaloj ajo prej këtij rreziku? Të gjitha mirrëshim vesh vetëm me sy edhe ajo sa shpejt e merr letrën e qet dorën kështu {vendosë duart mbrapa} edhe ia jep tjetrës mas. Domethonë, kjo ka qenë strategjia jonë. Po nalna pak n'qit' pikë se shumë interesant. Nuk na ka mësu neve kërkush si me u sillë aty, s'e di, vet jeta edhe vet momenti na ka mësu. Na ka mësu jeta aty. Nuk kem ditë na se si m'u gjindë aty. Na ka mësu vet jeta aty edhe atë letër ia kem dhanë tjetrës edhe ajo letër u sillë deri te tjetra krejt. Roja ka pa.

Edhe kur përfundoi ajo shëtitore ajo rreth që na e bamë, që e bojshim çdo ditë që ishte rregull e burgut edhe e nalën atë që u nal me marrë letrën, e nalën roja. Thotë, "Une s'kom", e kontrollon, s'ka. Atij s'ia ka, logjikisht s'e ka marrë që letrën ia ka dhanë tjetrit edhe kështu që e pshtum letrën na. E pshtum atë letër tu e sillë edhe ishim vajzat ma t'lumtura n'botë kur e pshtum letrën. Edhe jemi hi secila pa ftyrë, secila pa pikë gjaki prej frike. Jo për veti ma nuk kishim frikë ne aty. Nuk e di atë ditë nuk kishim frikë ndoshta edhe ajo ecja po dojshim letrën me me, mos me u vrejtë letra e kujt osht'.

Edhe e kemi marrë e kemi lexu secila prej frike se ishte vrimë ajo n'derë që shpahunojke, na nuk i shifshim jashtë ata ne po edhe e kishim frikë atë vrimën. E kemi marrë atë letrën e kemi nda në grima kemi dashtë me hudhë, me hudhë mbeturina. Ato nuk ishin mbeturina po ato ishin kontinjeri ku ne duhet me urinu edhe me... ashtu osht' burgu. Tha, "Po na me hudhë ktu", tha njana prej shoqeve tha, "Me hudhë ktu po erdhën e kqyrën thojnë diçka ka pasë edhe krejt malltretohem".

S'ishte shumë e madhe ajo letër {shpjegon me duar}, si do t'ja bojmë tash? "Po a ta ham secila nga nji pjesë letër?" Edhe e kemi përtypë secila ka ni pjesë letër që me hupë gjurmë. Sepse aty ishte edhe emri mbiemri i dikujt, për çudi kish shkru emrin e mbiemrin. Edhe na i hupëm gjurmë asaj letre, i hupëm gjurmë. Domethonë, ka qenë historia e "Vajzë këpucë me taka" që unë nuk e harroj kurrë. Janë me emna n'libër pak a shumë edhe ishte interesant sepse vitet '83, hapat ushtarak ishte pak herët. Domethonë, që më pas e sollën Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. E murëm guximin, ni guxim rinor që e kish secila noshta.

**Anita Susuri:** A ka pasë pastaj pasoja?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Atë ditë jo. Ajo atë ditë filloi edhe përfundoi aty nuk kemi pasë pasoja se hupën gjurmtë. Pajoja tjera kanë qenë... çdo ditë kemi qenë, çdo ditë ka pasë historia aty. Domethonë,

ka qenë kah ni histori aty, ka qenë kur, kur kem marrë pjatën edhe edhe e kem gjetë me emër e mbiemër n'pjatë edhe jemi malltretu secila, "Kush është ky emër?" Na e di shim kush është ajo, po nuk e tregojshim. "Ku ishte ti kur e shkroi kjo emrin?" "S'e di kush e ka shkru". Po jemi malltretu. Kem pasë qef secila me lonë gjurmë n'atë dhomë, me lonë pak histori.

Dikush me diçka, dikush me ni shkrim, dikush... unë e mbaj n'mend kur kom hy n'burg thanë, "Kjo ka qenë dhoma e Shotë Galicës", e Drita Kuqit, njo që ata i thojshin Shotë Galica. Kom ra n'kontakt tash pas shumë vjetve me to. Kështu që, ka lanë gjurmë, secila ka lanë gjurmë n'dhomë aty. Kemi lonë gjurmë aty domethonë. Ishte ni pjesë interesant. Pastaj, tani gjanat ndryshun kur dulëm prej burgut na, ndryshun gjanat, ishim të përndjekura...

**Anita Susuri:** E si ndodhi gjykimi edhe sa keni qëndru n'burg?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Ishim të përndjekura. Pas daljes nga burgu s'kishim të drejtë pune, s'kishim të drejtë lëvizje, s'kishim të drejtë kontakt me njerëz tjerë, ishim të përndjekur familjarisht. Mbajë mend ishte ni farmaci n'qytetin e Deçanit, farmaci, barnatore ma mirë me i thanë barnatore. Edhe unë s'kisha t'drejtë me punu aty unë nuk lejon unë me punu, isha pa punë. Edhe del konkursi për ni Teknike e farmacisë, nuk kisha t'drejtë me punu. Shkoj në Mitrovicë me punu aty u pranova, punova dy muj derisa shkun karakteristikat. Kur them karakteristikat na lem te ajo pjesë që asokohe, komuna, vendi ku ti ke jetu t'i ka mledhë karakteristikat. Nëse ti ke qenë e burgosun ose e përndjekur, kanë shku n'komunën tjetër domethonë edhe ti je largu prej pune. Kështu që, vazhdova studimet se... edhe jeta nuk ishte e lehtë atëherë sepse edhe njerz të ishin pak ma ndryshe si femën une. S'e di!

Ishin ato paragjykimet kjo me policë, kjo n'burg, ishin pak ato paragjykimet. Dikush m'kish n'qef, dikush na kish n'qef, por dikush edhe, "Po kjo ndryshe". Domethonë, na e kem pasë emrin, "Po kjo ndryshe", s'e di pse. Na thojshin, "Po kjo osht' ndryshe". Domethonë, jeta për ne nuk ishte e lehtë, nuk ishte e lehtë. Ishin... kështu që, me t'gjitha këto jeta vazhdoi. Atëherë aktiviteti vazhdoi sigurisht që vazhdojshim edhe ma t'forta, ishim edhe ma t'forta ishim edhe ma t'organizume. Kjo ndikoi që ne të forcohem edhe ma shumë edhe e thom me përgjegjësi shumë t'plotë se ma pak kem hy të vetëdijshme n'burg, shumë ma patriote kem dalë. Aty kem pa padrejtësitë. Pse thom kta? Sepse aty unë i pava gjanat e vërteta. Padrejtësitë i pava aty edhe ma shumë sesa kur isha ma e re, sesa pa hy n'burg.

Aty jemi ba ma t'fortë, aty jemi dalë shumë ma t'forta. Tu munu me na bo keq, me na zhdukë, me na dobësu, po na... ata nuk e kanë ditë që na kemi dalë ma t'forta. Ata veç e kanë forcu... njerëzit që i kanë marrë, që i kanë malltretu, që i kanë shti n'burg veç i kanë bo ma t'fortë. Edhe na kemi vazhdu me grup shoqesh kemi vazhdu aktivitetin. Sigurisht se n'rrethana edhe ma të vështira, se veç ramë n'sy t'armikut na, tani veç e dishin me emra kush jemi. Kështu që, nuk u nal aktiviteti edhe kur u bona nanë me fmi. Jo pse po e ngris vetën po pse isha hy n'atë radhë me shumë shoqe edhe secila e manim njana-tjetrën për dore domethonë. Kështu që, unë e maj mend edhe kur kom lanë djaln e vogël, kjo pjesë është shumë interesant.

**Anita Susuri:** Sa kohë keni qëndru n'burg edhe si ka qenë gjykimi? Si jeni liru? Edhe si e keni përjetu qat' lajmin e lirimit?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Nuk e di, na aty kemi qenë kohë pas kohe. Jemi dalë. Kur jom dalë e di që osht' ardhë baba m'ka marrë, baba i vjetër plak. Edhe e di që që m'kanë thanë, "Ti ki me ardhë apet", domethonë kanë qit këto provokimet e tyne. Edhe unë si vajzë e re që isha floktë bistek edhe e di që ma kanë sha bistekun që e pata. Nuk e di pse ata e morën ashtu si simbol nashta, si vajzë e re une. Edhe ishte ni jetë ndryshe. Kishim frikë tani prej... ishte ishte n'sy të tyne tani n'çdo lëvizje. Ni kohë e kom marrë vetën pak, kom pushu e kom marrë vetën. Pastaj e kom vazhdu si t'gjitha shoqet tjera me studimet, me ato përpjekjet me i tejkalu, me i tejkalu ato sepse ti ma veç ishte n'sy t'tyne.

Kështu që, ia kemi dalë mirë, falë, falë ndihmës t'prindërve, t'miqve, t'mikeshave. Toni jeta vazhdoi erdh ajo pjesa ku e familjes, domethonë e ekuilibrit, se familja osht' ekuilibër, ajo pjesa e familjes. Po gjithmonë unë me atë vullnetin që t'boj diçka prapë. E maj mend kur, kur... se tani u martova ni fshat tjetër, u bona nuse n'atë fshat edhe ish pak vështirë edhe nuse kur bohesh, ishe nuse ndryshe diçka. Mirëpo, ishte ni përtesë shumë e madhe në Deçan, m'kujtohet edhe unë kisha dy sfida. Sfida e parë ishte si t'i thom vjehrrës e vjehrrit që une kom me dalë dej në Deçan, se ata ishin shumë t'vjetër edhe nuk e kuptonin pse. Sfida e dytë ish si me ecën n'komë edhe sfida se si do t'kaloj në protestë.

Edhe unë e lo djalin e vogël. Shkoj n'komë prej fshatit në Deçan. Ishte protesta ma e rrezikshme, ka qenë. Jemi konë shumë t'rrethum. S'e kom ditë a kthethna, a s'kthethna. Aty e kom ditë që e kom lonë ni bebë t'vogël që s'jom mo ajo vajza e studimeve, po e kom lonë edhe ni jetë, ni frymë që unë e kom sjellë n'jetë. Edhe pak aty ka qenë moment i sikletshëm se kisha përgjegjësinë e djalit. Nuk ndodhi gjo atë ditë, thanë që krejt keni me u zhdukë atë ditë, "Krejt kemi me ju eliminu", "Jeni t'rrethum me shumë tanka". Fati deshti që nuk ndodhi diçka e keqe edhe unë u ktheva.

Por, gjatë gjithë rrugës tu u kthy unë t'u thonë, "Po si i thom vjehrrit edhe vjehrrës ku isha une", si të arsyetohna. Edhe ni shoqe që unë e falenderoj shumë, thotë, "Une", thotë, "kam me t'ndihmu. Une vi me ty", thotë, "ua sqaroj edhe nuk t'lo vetëm me hy aty". Edhe ajo u nda prej krejt shoqeve, vjen me mu. Une gjoj vjehrrin me djalë te dera tu pritë mamin ai. Edhe thotë, "Po ku kaq gjatë që u vonove ti?" Ajo ndërhy, ajo shoqja edhe m'arsyeton mu pak. Ai ka qenë moment i sikletshëm se s'kisha si të arsyetohna, se ishte pak tabu me i thonë vjehrrit une isha n'demonstrata, shkova. Thotë, "Po ti e di që je qishtu, po për qishtu me lonë bebë", osht' pak vështirë se isha e re, nanë e re. Isha mami e re edhe ndoshta u dashtë me m'kshillu pak se kisha lonë djalin e vogël.

Edhe kështu atë ditë për pak pshtova. Më pshtoi ajo shoqja edhe ka qenë moment i sikletshëm atë ditë shumë, shumë kur jom dalë se nuk i kom ditë rreziqet. Jo veç unë, por secila shoqe jemja ka qenë kështu. Edhe ajo që m'pruni deri aty ka bo ni punë t'jashtëzakonshme, se unë s'e harroj kurrë që m'arsyetoi. Ishte vjehrrit shumë i mirë edhe vjehrra, familje e mirë. Por, për ni nuse pak me bo ato hapa ish pak tabu asokohe. Edhe kjo ka qenë ni pjesë e historisë interesant që s'e harroj kurrë.

**Anita Susuri:** E si jeni njoftu ju me bashkëshortin e ju?



**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Në vitin e dytë fakultet pak para se me ra n'burg unë jom njoftu, jemi feju. Sigurisht që edhe ai ka qenë student i Fakultetit të Mjekësisë, unë studente jemi njoftë në fakultet, n'konvikt.

**Anita Susuri:** A ka qenë në ilegale ai?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Edhe ai ka qenë. Aty jemi njoftë, u bo fejesa mas ni kohe tani gjanat shkunë, rrjedhën erdhën deri te familja. Me kriju familje.

**Anita Susuri:** Kemi ndëgju që edhe personat që kanë qenë në ilegale janë martu djem vajza ndërmjet vete?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po, ka pasë. Kësaj i thonë shok të idealit. Ne atëherë kemi thanë shokë të idealit, që do të thotë se ishim ni ideal. Ishte ni ideal atëherë edhe po ishte e vërtetë që i ka bashku ideali njerztë, i ka bashku ideali. Ishte ni ideal atëherë. Kështu që, pas luftës sot u zbeh kjo ideali, tash osht' parti. Domethonë, osht' parti politike që njerëzit i ka nda n'parti. Atëherë, nuk ka pasë parti, ka qenë ni ideal. Edhe na sigurisht që kemi qenë miq me këto, ndoshta aty edhe kanë lindë dashuritë, kanë lindë edhe njohjet, kanë lindë edhe njohjet atje në, në...

**Anita Susuri:** Domethonë, bashkëshorti juj e ka kuptu që...

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po. M'kanë pritë shumë mirë. I falënderoj edhe familjen e burrit edhe vjehrrinë që kur dikush i ka pytë thotë, "A do me marrë tash nusen se kjo tash veç e burgosun?" Thotë, "Nëse niherë e kom dashtë, kom me dashtë dhetë herë ma shumë". Edhe kjo m'ka bo shumë mirë, m'ka bo shumë t'fortë. I falënderoj sot për atëherë që m'kanë pranu shumë mirë, se ka pasë raste kur njerztë edhe janë frigu edhe... mirëpo, unë e kom lanë ni familje shumë t'mirë edhe e kom gjetë ni familje që m'ka pritë mirë. Pastaj, tani...

**Anita Susuri:** N'burg sa keni qenë, s'keni pasë t'drejta për vizita apo?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Kem pasë vizita po, po ka qenë vizita. Kanë ardhë për vizitë, ka ardhë nana, ka ardhë baba, ka ardhë i fejumi, kanë ardhë për vizitë. Sigurisht që kemi qenë t'kufizuar, s'ke guxu me folë shumë veç, "A je mirë?" Domethonë, pak. Po, po une s'e di, si e re nuk o si, u bona e fortë, s'e di që kom kajtë para tyne. As ata, as nana, s'e di. Nashta tash jom ma e dobtë, s'e di. Po, mirë...

**Anita Susuri:** E sa kohë keni qëndru n'burg?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Mirë, mirë kemi kalu gjatë vizitave. Secila e mësojshim njana-tjetrën, "Qishtu fol, qishtu bon, se kta përherë reagojnë". Nejse, ti niherë m'shkoj goja me thanë, "Nanë unë jom shumë mirë, kom shoqe e kom kto", edhe jom dënu me ni vizitë mangi. Pse une për pak deshta me thanë që e kom ni shoqe shumë t'mirë, se kom shumë shoqe t'mira, aty stop, domethonë. Nuk lejohen këto. Mirëpo, pshtun domethonë. Ka pasë edhe që janë smu prej malltretimeve aty, ka pasë... po falë



Zotit, falë Zotit dulëm, dulëm ia dulëm dhe jeta ndryshoi masanena, jeta ndryshoi se gjanat vazhdun, gjanat... mas burgut ishte ni jetë tjetër, ishte edhe ajo jo ma pak e ranë.

Tani këto sfidat e shumta të femnës, që osht' familja, ekuilibri i familjes që fillon e përballesh me gjana tjera. Pastaj lufta, pastaj mas luftës tash këto partitë politike që sistemi shumë partiak. Pas lufte nuk u sqaru mirë, nuk u prit mirë. Kemi mendu që do t'jemi krejt bashkë, kemi mendu që sistemi shumë partiak nuk do t'bon ndasi, nuk do t'shërbejë, "Përçaj e sundo", nuk do t'shërbejë kjo fraza. Por do t'jetë, jo muri po urë. Kemi mendu që do t'jetë ni urëlidhëse, domethonë sistemi shumë partiak. Po secili ka zgjedhë atë drejtimin e vet, tash pas lufte o fjala, tash vitet e '20, '15, '20 e tutje. Tash jetoj në Deçan i kom pesë fmi. Jetoj me burrin e me pesë fmi. Sigurisht që familja u rritë kom nipa e mesa.

**Anita Susuri:** Po du pak me u kthy te fakultetin kur e keni përfunduar?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** E kjo historia e fakultetit. Sigurisht që s'kisha të drejtë fakulteti. Me ndihmën e disa profesorëve t'mirë unë arrita që t'shkoj deri n'absolventiadë, domethonë të absolvojë me provime. Edhe kur unë martohesha, martohem në atë kohë sigurisht që mbetën pak provime, mbetën t'cilat jom përpjekë kohë pas kohe me udhëtu prej fshatit. Ishte dëshira e madhe që unë me diplomu edhe prej fshatit kom ardhë, me bebë nashta kom ardhë. Pas ni kohe t'gjatë nashta, jo meniherë, kom arritë me diplomu. Se pak provime mbetën po m'kanë ndihmu shumë profesorët, me ndihmën e profesorëve t'mirë kom arritë me diplomu.

Pastaj kjo pjesa tjetër që unë, nuk e di pse, nuk e di pse fati s'ish fort në anën tem pas luftës domethonë. Edhe sot këto ditë, për shkak t'punësimit noshta, me prek pak këtë pjesën që nëse ti ma bon ni pyetje çka ki ti peng n'jetë? Unë e kom ni peng n'jetë që shkak i bindjeve partiake unë jom largu dy herë prej pune në Deçan. Megjithatë, mund që bona une me diplomu se s'ishte e lehtë me diplomu, kohë pas kohe domethonë me ni periudhë kohore, jepe ni provim pastaj... arrita me diplomu. Mirëpo, osht' kjo historia e dhimbshme që shkak i bindjeve partiake unë dy herë jam largu prej punës në Deçan.

**Anita Susuri:** Tash viteve t'fundit apo?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po, po, unë jom e papunë. Sot kur unë flas, domethonë jom papunë. Edhe pse kom diplomu, jom profesoreshë e Gjuhës shqipe, e kom kry edhe jom çertifiku për vend udhëheqës n'arsim, domethonë për drejtor. Edhe pse kom majtë trajnime edhe jom çertifiku për bibliotekë se është lidhë me profesion Letërsi e gjuhë. Edhe pse kom kry trajnime për edukim shëndetësor e kom lidhë pak me farmaci, nuk e di, Deçani nuk u... shkak bindjeve partiake ose s'e di arsyeën pse ata... edhe kjo është peng i madh n'jetë që unë nuk arrita t'spjegoj emrin as mbiemrin që kom studiu domethonë. Mirëpo, familjen e kom t'shnoshë, osht' kjo pjesa knena që jom e përmbushun.

**Anita Susuri:** Deshta me folë edhe për vitet e '90-ta që kanë qenë vite mjaft t'vështira kur janë largu shumica prej punës për shkak t'sistemit i kanë largu...

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po.

**Anita Susuri:** Si ka qenë për juve kjo?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Vitet e '90-ta mu m'ka gjetë nanë me fmi. Ka qenë ajo periudha kur unë isha nanë, isha me detyra shumë t'mëdha familjare. Sigurisht që n'kushte jo edhe aq t'mira edhe kjo pjesa ish shumë bindje. Pastaj ndodhi lufta edhe si t'gjitha nanat, si t'gjithë qytetartë e Republikës të Kosovës që janë përballë me shumë sfida, me shumë...

**Anita Susuri:** A jeni largu n'atë kohë? Si ka ndodhë?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Ni kohë kemi qenë aty n'fshat. Ni kohë. Tani i kom marrë fëmijë jom dalë, domethonë i kom, ni shpërblim i fëmive qysh me i pshtu fmitë. Isha me katër fëmi. Kështu që, ishin ato përplasjet, ato malltretimet, ato vujtjet e secilit ishin që si temë e veçantë që s'kisha pasë qef shumë me folë se u konë ni terror, ni tmerr, ni luftë e pabarabartë, ni tmerr, ni dyndje e madhe e popullsisë prej fshatit n'fshat. Mirëpo, kjo metë n'histori. Prej fshatit n'fshat kanë qenë dyndjet ma t'mëdha populllore. Dyndjet e mëdha populllore, helmimet n'shkolla. Nuk dishe ku me shku, nuk dishe ku i ki fëmijë ma t'sigurtë, ku e ki familjen ma t'sigurtë. Po flas për nana, po flas për çështjen e nanave që e kishim na përgjegjësinë e fëmive.

**Anita Susuri:** Nëse mundeni me tregu pas luftës si ka ndodhë kjo rimëkëmbja? Vazhdimi i jetës?

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Po, po. Pas luftës gjanat ndryshun erdh sistemi shumë partiak që menoj që nuk u prit edhe aq mirë, që n'vend që t'krijohen, n'vend që t'krijohen ura u krijun mure, pak a shumë. Mu m'gjetej në, në Deçan me pesë fmi isha profesoreshë e Gjuhës shqipe. Punova, punova pesë vjet me para filloren me ni fshat t'komunës të Deçanit. Burri punonte. Kështu që... fmija veç u rritën. Djali i madh studjoi për stomatologji, Arbëri. Edhe i dyti studjoi për stomatologji. Kushtet ishin pak ma t'vështira se ishte n'pytje ishte shkollimi i fëmive. Po flas pak për fëmijë, domethonë për familjen tash që kom. Dy djemtë e mëdhej të dytë studjun për stomatologji, Arbëri, Miloti.

Pastaj vijnë tri vajzat, mas dy djemve vijnë tri vajza. Fortuna edhe ajo është mjeke, radiologe. Pastaj osht' Fatbardha edhe ajo studjoi për fizioterapi edhe për stomatologji edhe ajo. Osht' edhe ajo tash n'fund t'studimeve për stomatologji, se e përfundoi fizioterapinë. Domethonë, u bonë katër. Kurse vajza e vogël studjon në Akadami të Arteve për muzikë. Kjo është familja jem.

Unë përpiqem që t'boj diçka gjithmonë. Edhe pse osht' pengu i madh që m'hoqën prej pune për shkakun që nuk e di as vet. Punova, pas pesë vjetve punova me kontratë mbi vepër në bibliotekën e qytetit. Punova dy vjet me kontratë mbi vepër. Tetë muj kom punu pa kontratë, punë vullnetare për nxënësit edhe për lexuesit, edhe aty m'hoqën. Pas shumë përpjekjeve, pas shumë konkurseve që dolën për arsim për drejtori nuk arrita që t'punësohem.

Mirëpo, unë sot jom në Shoqatën e Shkrimtarëve të Pejës, jom në Shoqatën e ish të Burgosurve Politik, mirrem me shkrime. Kom botu librin e parë në tetor 2021. Libri i parë që u dalë që t'ju lo kujtim ose t'ju

lo si dhuratë, domethonë këtë libër e kom bo si dhuratë. Dhurata ma e bukur që mund t'i boj dikush fëmive, familjes edhe shoqnisë. Osht' ni libër që u botu tani edhe jom shumë e lumtur që ka gjana t'mira aty që unë i kisha thanë këtij libri, "Jeto për t'lanë gjurmë".

Edhe ka qenë andrra ime ekskluzive që unë për t'lanë gjurmë. Pas shumë përpjekjeve që u largova prej pune, pas shumë përpjekjeve që pata që t'ju nimoj të tjerëve, domethonë t'ju nimoj n'arsim, n'kulturë. Mu nuk m'u dha ni vend i punës që unë t'i shoh përditë, t'i shoh përditë 50 nxanës, që t'dal përditë para tyne t'ju flas për këto. Nuk e pata atë mundësi. Kështu që, vendosa ta botoj atë libër që t'lo gjurmë, që t'kontriboj pak a shumë edhe për gjeneratën e re edhe t' respektoj t'gjithë t'afërmit edhe t'jetë... kështu që, duhet t'ndalem prapë sepse duhet t'mendoj t'boj apet gjana, t'krijoj diçka përpos këtij libri ose kjo osht' ajo.

**Anita Susuri:** Zonja Zyrafete, nëse keni edhe diçka për fund me shtu ose që keni harru me tregu.

**Zyrafete Berisha-Lushaj:** Unë ju falënderoj shumë juve. Ishte një bisedë e ngrohtë, ni bisedë familjare. Ju falënderoj shumë juve si vajza t'reja, ndoshta diku edhe s'kom arritë mirë shkaku i emocioneve, shkaku i përjetimeve, se kur tregon histori sigurisht që ti për atë moment je n'qato ditë edhe e përfshime n'qato emocione ndoshta kom lonë mangi edhe nuk kom arritë. Ju m'kuptoni. Mirëpo, krejt çka kom dashtë me thonë që ishte ni intervistë e sinqertë, ni intervistë me emocion, ni intervistë e drejtpërdrejtë pa zbulurime, pa ato gjanat që mbojnë mu kushedi ma t'naltë, intervistë e thjeshtë.

Ju falënderoj juve shumë edhe që zgjodhët, që keni gjetë emrin tem n'mesin e t'gjithë atyne emrave edhe uroj t'kom kontribu pak, t'ju kom ndihmu edhe juve pak si vajza t'reja, si gjeneratë e re që pas shumë vjetve t'i shërbej kjo secilit. Është ni kontribut i jemi që unë e kom dhanë, po osht' edhe ni kontribut i juve se edhe ju ni ditë boni si na edhe pas juve dikush i lexon këto histori edhe është emri juaj domethonë. Ju keni bo këtë intervistë edhe osht' ni kontribut shumë i madh i juve.

**Anita Susuri:** Faleminderit edhe juve për kontributin edhe intervistën!